

RAPORTI MBI MONITORIMIN E PUBLIKIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE



JANAR – DHJETOR 2024



Titulli: Raporti mbi monitorimin e publikimit të vendimeve gjyqësore (janar - dhjetor 2024)

Autorë: Lëvizja FOL

Viti i botimit: Qershor 2025

Publikuar nga: Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35

Prishtina 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org

+386 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2025. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4
1. METODOLOGJIA	10
2. BAZA LIGJORE E PUBLIKIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE	12
3. GJYKATA SUPREME	14
4. GJYKATA E AELIT	18
6. GJYKATA KOMERCIALE	21
5. GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS	25
7. GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS	29
8. GJYKATA THEMELORE E PEJËS	33
9. GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT	36
10. GJYKATA THEMELORE E FERIZAJT	39
11. GJYKATA THEMELORE E GJILANIT	43
12. GJYKATA THEMELORE E GJAKOVËS	47
13. REKOMANDIME	51

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Raporti mbi monitorimin e publikimit të vendimeve gjyqësore për periudhën janar–dhjetor 2024 përmban të dhëna të mbledhura përmes monitorimit sistematik të aktgjykimeve të publikuara në ueb-faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë kësaj periudhe njëvjeçare.

Gjetjet kryesore që rrjedhin nga monitorimi i vendimeve janë renditur në tekstin e mëposhtëm:

- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 në ueb-faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë publikuar gjithsej 56,559 vendime. Gjatë kësaj periudhe janë zgjidhur gjithsej 155,003 lëndë (me përjashtim të lëndëve që nuk do të duhej të publikoheshin)¹, që nënkupton se janë publikuar 36 % e lëndëve të zgjidhura.²
- Ky nivel i publikimit dëshmon rritje të publikimit prej 40% në krahasim me vitin 2023, ku në ueb-faqen e KGJK-së ishin publikuar 40,424 vendime, përkatësisht 35 % e lëndëve të zgjidhura.
- Gjykatat me më së shumti vendime të publikuara në proporcion me lëndët e zgjidhura gjatë periudhës përkatëse janë:
 - **Gjykata Komerciale** – përkatësisht Dhoma e Shkallës së Parë ka zgjidhur 4,276 lëndë, ndërsa ka publikuar 4,028 vendime (94 % të lëndëve), ndërsa Dhoma e Shkallës së Dytë ka zgjidhur 2,145 lëndë ndërsa ka publikuar 2,056 vendime (96 % të lëndëve);
 - **Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 3,376 lëndë, ndërsa ka publikuar 2,619 vendime (78 % të lëndëve), ndërsa **Gjykata Supreme** ka zgjidhur 2,195 lëndë, ndërsa ka publikuar 1,606 lëndë (73%).
 - **Gjykata Themelore e Gjakovës** – e cila nga 11,767 lëndë të zgjidhura, ka publikuar 7,803 vendime gjyqësore (66%). Pra kjo gjykatë renditet e para në mesin e shtatë gjykatave themelore sa i përket trasnparencës në publikimin e vendimeve gjyqësore, pasuar nga **Gjykata Themelore e Mitrovicës**, e cila nga 17,007 lëndë të zgjidhura, ka publikuar 8,662 lëndë, përkatësisht 51% të lëndëve të zgjidhura.
- Ndërsa gjykatat të cilat kanë publikuar më pak vendime gjyqësore për vitin 2024, në raport me lëndët e zgjidhura, janë:

¹ Në raportin vjetor statistikor të KGJK-së, janë kategorizuar vetëm lëndët për të mitur dhe kundërvajtjet, lëndë të cilat sipas KPPK-së dhe Rregullores së KGJK-së, nuk do të duhej të publikoheshin. Ndërsa kategoritë e tjera të lëndëve që nuk do të duhej të publikoheshin nuk janë veçuar në tabelat e KGJK-së. Prandaj FOL, i ka zbritur vetëm këto lëndë nga numri total i lëndëve të zgjidhura.

² Në këto shifra nuk janë përfshirë vendimet e njejta që janë evidentuar gjatë monitorimit si dhe procesverbalet e publikuara nga ana e gjykatave, që gjithsej përbëjnë 3,544 vendime të tilla. Kjo kryesisht ka ndodhur për shkak të sfidave teknike të ueb faqes së KGJK-së e cila edhe gjatë gjithë këtij viti është përballur me vështirësi në publikimin e dy apo më shumë aktgjykimeve të njëjta.

- **Gjykata Themelore e Pejës**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 17,972 lëndë, ndërsa ka publikuar vetëm 2,315 vendime (13 % të lëndëve);
 - **Gjykata Themelore e Prishtinës**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 35,545 lëndë, ndërsa ka publikuar vetëm 5,450 vendime (15 % të lëndëve); si dhe
 - **Gjykata Themelore e Gjilanit**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 15,586 lëndë, ndërsa ka publikuar vetëm 4,726 vendime (30 % të lëndëve);
- Degët e gjykatave me më së shumti vendime të publikuara në proporcion me lëndët e zgjidhura gjatë periudhës së monitorimit janë:
- **Dega e Novobërdes**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 589 lëndë, ndërsa ka publikuar 492 vendime (83 % të lëndëve),
 - **Dega e Leposaviqit**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 312 lëndë, ndërsa ka publikuar 210 vendime (67 % të lëndëve),
 - **Dega e Malishevës**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 3,049 lëndë, ndërsa ka publikuar 1,736 vendime (34 % të lëndëve).
- Gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe të Gjykatës Themelore të Gjakovës prijnë me numrin e vendimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe. I pari në renditje qëndron gjyqtari *Leutrim Gashi nga Gjykata Themelore e Mitrovicës*, i cili gjatë kësaj periudhe ka publikuar 1,010 vendime. Më pas renditet gjyqtari *Jeton Zymeri*, po ashtu nga Gjykata Themelore e Mitrovicës, i cili ka publikuar 839 vendime, si dhe gjyqtari nga Gjykata Themelore e Gjakovës, *Berkan Hamza* me 726 vendime të publikuara.
- Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare, nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, 67% i takojnë fushës civile, 19% fushës penale, 7% ekonomike, 5% administrative dhe 3% fushës fiskale.
- Gjatë kësaj periudhe janë publikuar 267 vendime të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe 19 vendime të dhunës në familje³.
- Gjatë kësaj periudhe të monitorimit, zbatimi në përpikmëri i Vendimit të KGJK-së për Standardizimin e Formave të Vendimeve është evidentuar në 85% të të gjitha vendimeve të publikuara. Në pjesën tjetër, përkatësisht në 15% të tyre, është vërejtur ngecje në zbatimin e këtij vendimi.
- Gjatë kësaj periudhe, 98% e vendimeve janë publikuar në gjuhën shqipe, ndërsa vetëm 2% e vendimeve janë publikuar në gjuhën serbe, përqindje që mbetet e pandryshuar krahasuar me vitin e kaluar.
- Gjykatave u janë dashur mesatarisht 69 ditë për t'i publikuar vendimet në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së, llogaritur nga dita e shpalljes së tyre, që nënkupton se gjykatat në përgjithsi e kanë

³ Bazuar në nenin 370, par.2 të KPPK-së, lëndët që kanë të bëjnë me veprat penale në kuadër të marrëdhënieve familjare nuk duhet të publikohen.

respektuar afatin e paraparë me ligj për publikimin e tyre. Më së shumti kohë në publikimin e vendimeve llogaritur nga dita e nxjerrjes i janë dashur *Gjykatës Themelore të Prishtinës, përkatësisht 174 ditë*.

- Ueb-faqja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës vazhdon të përballet me probleme teknike në lidhje me numërimin automatik të aktgjykimeve. Gjatë krahasimit të të dhënave, është vërejtur se numri i aktgjykimeve të publikuara manualisht në baza mujore është dukshëm më i lartë sesa ai i raportuar automatikisht nga sistemi i faqes. Kjo mospërputhje është rezultat i një defekti teknik, i cili ka bërë që shumë vendime të përsëriten në sistem. Si pasojë, një numër i madh i vendimeve janë larguar për të korrigjuar këto dublikime.

Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat në lidhje me numrin e lëndëve të zgjidhura si dhe të vendimeve të publikuara në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 nga të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe degët e gjykatave.

Gjykatat e Republikës së Kosovës		Numri i lëndëve të zgjidhura	Numri i aktgjykimeve të publikuara	Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe atyre të publikuara, e shprehur në %.
Gjykata Supreme		2,195	1,606	73%
Dhoma e Posaçme		3,376	2,619	78%
Gjykata e Apelit		20,190	8,621	43%
Gjykata Themelore e Prishtinës		35,545	5,450	15%
Gjykata Themelore e Ferizajt		10,005	3,063	31%
Gjykata Themelore e Mitrovicës		17,007	8,662	51%
Gjykata Themelore e Prizrenit		14,972	5,609	37%
Gjykata Themelore e Gjakovës		11,767	7,803	66%
Gjykata Themelore e Pejës		17,972	2,315	13%
Gjykata Themelore e Gjilanit		15,586	4,726	30%
Gjykata Komerciale	Shkalla I	4,276	4,028	95%
	Shkalla II	2,145	2,056	96%
TOTAL		155,033	56,559	36%

Tabela 1. Lëndët e zgjidhura dhe vendimet e publikuara nga të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës në ueb-faqen e Keshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Ndërsa në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat në lidhje me numrin e lëndëve të zgjidhura si dhe të vendimeve të publikuara në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 nga të gjitha degët e Gjykatave të Republikës së Kosovës.

Gjykatat Themelore	Degët e gjykatave themelore	Numri i lëndëve të zgjidhura	Numri i aktgjykimeve të publikuara	Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe atyre të publikuara, shprehur në %.
Gjykata Themelore në Prishtinë	Dega në Podujevë	6,191	479	8%
	Dega në Gracanicë	1,125	59	5%
	Dega në Lipjan	4,968	662	13%
	Dega në Glllogoc	3,803	307	8%
	Dega në Fushë Kosovë	5,177	374	7%
Gjykata Themelore në Gjilan	Dega në Kamenicë	2,759	806	29%
	Dega në Viti	4,674	852	18%
	Dega në Novobërdë	589	492	83%
Gjykata Themelore në Prizren	Dega në Suharekë	3,948	568	14%
	Dega në Dragash	756	263	35%
Gjykata Themelore në Mitrovicë	Dega në Leposaviq	312	210	67%
	Dega në Vushtrri	6,948	3,114	45%
	Dega në Zubin Potok	93	21	23%
	Dega në Skenderaj	3,186	1,806	57%
Gjykata Themelore në Gjakovë	Dega në Malishevë	3,049	1,736	57%
	Dega në Rahovec	3,901	2,114	54%
Gjykata Themelore në Pejë	Dega në Istog	2,423	426	18%
	Dega në Klinë	3,117	246	8%
	Dega në Deçan	4,024	414	10%
Gjykata Themelore në Ferizaj	Dega në Kaçanik	2,084	711	34%
	Dega në Shtrëpcë	693	84	12%
TOTAL		63,820	15,744	25%

Tabela 2. Lëndët e zgjidhura dhe vendimet e publikuara nga të gjitha degët e Gjykatave të Republikës së Kosovës në ueb-faqen e Keshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

1. METODOLOGJIA

Raporti mbi monitorimin e vendimeve gjyqësore ka për qëllim të paraqesë gjendjen faktike të publikimit të aktgjykimeve dhe aktvendimeve nga gjykatat e Republikës së Kosovës. Përmes këtij raporti identifikohen si sfidat me të cilat përballen gjykatat në përmbushjen e obligimeve ligjore për publikimin e vendimeve, ashtu edhe arritjet e tyre në këtë drejtim, duke kontribuar kështu në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut.

Për përpilimin e të dhënave të këtij raporti, Lëvizja FOL ka zbatuar metodën e monitorimit të vazhdueshëm dhe sistematik të të gjitha aktgjykimeve dhe aktvendimeve të publikuara në ueb-faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Paraprakisht, të gjitha gjykatat janë informuar përmes postës elektronike se do të jenë subjekt i monitorimit për dinamikën e publikimit të vendimeve gjyqësore, si dhe nëse publikimi i vendimeve është bërë konform kërkesave ligjore, udhëzimeve administrative dhe të vendimeve tjera relevante në fuqi. Të dhënat e mbledhura nga ky proces i monitorimit janë projektuar në formë infografikash dhe janë publikuar për çdo tre muaj në rrjetet sociale të Lëvizjes FOL.

Nga vendimet e publikuara në ueb-faqen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Lëvizja FOL ka krijuar një databazë me të dhëna. Rrjedhimisht, vendimet e njejta të evidentuara gjatë kësaj periudhe nuk janë përfshirë në këtë databazë. Kjo databazë, ndër të tjera, përfshinë:

- numrin e përgjithshëm të aktgjykimeve dhe aktvendimeve të publikuara nga çdo gjykatë, për çdo muaj;
- nivelin e respektimit të afateve të parapara me aktet nënligjore për publikimin e vendimeve, si dhe pajtueshmëria e aktgjykimeve/aktvendimeve të publikuara me Ligjin për Gjykatat dhe udhëzimet administrative;
- gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti vendime;
- nivelin e zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve (vendosjen e llogos së Republikës së Kosovës, formati i duhur i vendimit);
- gjuhën në të cilën janë publikuar vendimet, si dhe
- llojin dhe natyrën e vendimeve të publikuara.

Për të nxjerrur një përqindje të saktë të nivelit të publikimit të vendimeve gjyqësore nga gjykatat përkatëse, duhet ditur edhe numrin e lëndëve që kanë marrur epilog gjyqësor gjatë periudhës së monitorimit. Prandaj, FOL ka krahasuar numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës së monitorimit për secilën gjykatë me numrin e lëndëve të publikuara në secilën gjykatë gjatë asaj periudhe.

Për t'a arritur këtë, numri i lëndëve të zgjidhura nga të gjitha gjykatat dhe degët e tyre është nxjerrur nga Raporti Statistikor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2024.⁴

Në mënyrë që të reflektohet përqindja e saktë e shkallës së publikimit të vendimeve, nga numri i lëndëve të zgjidhura për secilën gjykatë *janë zbritur*:

⁴ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Departamenti i Statistikave, Raporti Statistikor Vjetor i Gjykatave për vitin 2024.

- *vendimet për të mitur (publikimi i të cilave është përjashtuar me Kodin Nr. 24 / 17 e Procedurës Penale, 370 par. 2); dhe*
- *vendimet për kundërvajtje (publikimi i të cilave është përjashtuar me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2025 për publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara).*

Me KPP dhe udhëzimin në fuqi janë përjashtuar nga publikimi edhe disa kategori të tjera të lëndëve (*veprat penale të kryera në kuadër të marrëdhënies familjare, veprat penale kundër integritetit seksual, aktgjykimet nga kontestet martesore, si dhe aktgjykimet për mbajtje financiare dhe ushqimi, vërtetim apo kundërshtim të atësisë, dhe kujdestari të personit të mitur*). Mirëpo në raportin statistikor të KGJK-së, këto lëndë nuk kanë qenë të kategorizuara, prandaj nuk ka qenë e mundur zbritja e tyre nga numri total i lëndëve të zgjidhura.

2. BAZA LIGJORE E PUBLIKIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE

Publikimi i vendimeve gjyqësore përveç se është obligim ligjor, është parim i rëndësishëm për një gjyqësor të hapur, transparent dhe llogaridhënës.

Me qëllim të përmbushjes së këtij parimi, Ligji për Gjykatat (Nr. 06/L – 054)⁵ që u miratua në dhjetor të vitit 2018 dhe që është aktualisht në fuqi, ka bërë progres në rritjen e transparencës së gjyqësorit, duke e bërë të detyrueshme për të gjitha gjykatat publikimin e të gjitha vendimeve brenda 60 ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në faqet e tyre të internetit. Pra ky ligj i ka obliguar gjykatat që të publikojnë të gjitha vendimet, pavarësisht plotfuqishmërisë ligjore, ndryshe nga ligji paraprak, i cili i obligonte gjykatat të publikojnë vetëm vendimet e formës së prerë.

Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, i cili hyri në fuqi në shkurt të vitit 2023, në nenin 370 të tij rregullon çështjen e publikimit të aktgjyqimeve. Në paragrafin 2 të këtij neni është paraparë përjashtim në publikimin e aktgjyqimeve në rastet kur të miturit janë të përfshirë si palë, në rastet kur pretendohet se veprat penale janë kryer në kuadër të marrëdhënieve familjare apo në rastet e veprave penale kundër integritetit seksual.

Gjithashtu, Kodi i ri i Procedurës Penale, kishte paraparë se përveç numrit personal, datës së lindjes, emrit të prindërve dhe vendlindjes, publikimi i të dhënave të tjera personale, nuk konsiderohet shkelje e privatësisë, për shkak të interesit të publikut për një gjyqësor të hapur dhe publik.⁶

Përveç akteve ligjore si Ligji për Gjykatat, Kodi i Procedurës Penale, KGJK ka arritur që përmes akteve nënligjore të rregullojë dhe të përmisojë infrastrukturën e publikimit të vendimeve ligjore. Rrjedhimisht, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në vitin 2018 nxori *Vendimin për Standardizimin e Formave të Vendimeve* dhe krijoi grupin punues për krijimin e *Shabllonit për Standardizimin e Formave*.

Për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë publikimit të vendimeve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në fund të vitit 2019 ka nxjerrë *Udhëzimin e ri Administrativ për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara dhe Manualin për Publikimin dhe Përpunimin e Vendimeve*. Në fund të vitit 2021 ky udhëzim pësoj disa ndryshime. Përkatesisht, në dhjetor të vitit 2021, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr. 01/2021⁷ për plotësimin dhe ndryshimin e *Udhëzimit Administrativ 04/2019 për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara*. Si një prej ndryshimeve esenciale të parapara në këtë ndryshim/plotësim, ishte se përveç vendimeve, gjykatat obligohen të publikojnë edhe aktvendimet meritorë.

Gjatë vitit 2024, KGJK kishte filluar punën për hartimin e një udhëzimi të ri administrativ për publikimin e vendimeve gjyqësore, si pasojë e ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale dhe përmbushjes së

⁵ Ligji Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, 2018, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

⁶ Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 369, par. 13.

⁷ [https://ëëë.gjyqesori-rks.org/ëp-](https://ëëë.gjyqesori-rks.org/ëp-content/uploads/lgs/60388_Udhezim_Administrativ_Nr_01_2021_per_plotesimin_dhe_ndryshimin_Udhezimit_Administrativ_04_2019_per_publikimin_vendimeve_te_perpunuara.pdf)

[content/uploads/lgs/60388_Udhezim_Administrativ_Nr_01_2021_per_plotesimin_dhe_ndryshimin_Udhezimit_Administrativ_04_2019_per_publikimin_vendimeve_te_perpunuara.pdf](https://ëëë.gjyqesori-rks.org/ëp-content/uploads/lgs/60388_Udhezim_Administrativ_Nr_01_2021_per_plotesimin_dhe_ndryshimin_Udhezimit_Administrativ_04_2019_per_publikimin_vendimeve_te_perpunuara.pdf)

kërkesave të reja ligjore. Rrjedhimisht, në fillim të vitit 2025, konkretisht në mbledhjen e 343-të të KGJK-së është miratuar ⁸*Udhëzimi Administrativ 01/2025 për Publikimin e Vendimeve Gjyqësore*.⁹

Ky udhëzim është hartuar në harmoni me Kodin e ri të Procedurës Penale. Rrjedhimisht, i njëjti parasheh që tek vendimet gjyqësore penale publikohet emri dhe mbiemri i të pandehurit dhe emrat e ekspertëve, ndërsa anonimizohen: numri personal, data dhe vendi i lindjes, vendbanimi si dhe emri i prindërve.


⁸ <https://ëëë.gjyqesori-rks.org/2025/02/28/miratohet-udhezimi-administrativ-per-publikimin-e-vendimeve-gjyqesore/>

⁹ Udhëzimi Administrativ 01/2025 për Publikimin e Vendimeve Gjyqësore

3. GJYKATA SUPREME


Gjykata Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 ka publikuar gjithsej 1,606 vendime gjyqësore, përkatësisht 73% të vendimeve të zgjidhura.¹⁰ Ky nivel i publikimit dëshmon rritje në krahasim me vitin paraprak, ku Gjykata Supreme kishte publikuar gjithsej 1,135 vendime, përkatësisht 41% më shumë.

Me këtë nivel të publikimit, kjo gjykatë renditet e dyta me rradhë në kuadër të të gjitha gjykatave.



Grafika 1. Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.


Në figurën e mëposhtëm është pasqyruar niveli i publikimit të vendimeve nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar – dhjetor 2024, për secilin muaj.



Grafika 2. Niveli i publikimit të vendimeve gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 në Gjykatën Supreme.


Ndërkaq **Dhoma e Posaçme** e kësaj gjykate gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 ka publikuar 2,619 vendime nga 3,164 lëndë të zgjidhura gjithsej gjatë kësaj periudhe, përkatësisht 83% të vendimeve. Ndërsa Kolegji i *Apelit* për këtë periudhë nuk ka publikuar asnjë vendim.

¹⁰ Në këtë shifër nuk janë llogaritur aktgjykimet e përsëritura, të cilat kanë figuruar në ueb faqën e KGJK-së.




Grafika 3. Niveli i publikimit të vendimeve gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 në Dhomën e Posaçme.

Publikimi mujor i vendimeve nga Dhoma e Posaçme gjatë vitit 2024 është paraqitur në mënyrë grafike në figurën e mëposhtme. Kjo paraqitje vizuale ilustron trendin e publikimeve për secilin muaj kalendarik, duke mundësuar një analizë më të lehtë të ritmit dhe vazhdimësisë së publikimit të vendimeve nga kjo gjykatë.



Grafika 3. Niveli i publikimit të vendimeve nga Dhoma e Posaçme gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.


Pjesa më e madhe e vendimeve të publikuara nga Gjykata Supreme janë të natyrës civile, respektivisht 3,610 vendime civile, 447 prej tyre janë të natyrës penale dhe 209 vendime të natyrës administrative. Në grafikën në vijim është paraqitur lloji i vendimeve të publikuara nga Gjykata Supreme.



Grafika 4. Lloji i vendimeve të publikuara nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, gjatë kësaj periudhe të monitorimit Gjykata Supreme në tërësi ka publikuar 15 vendime në lidhje me veprat penale të korrupsionit, ndërsa ka publikuar 2 vendime të dhunës në familje.


Ndërsa sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar vendimet, 3,869 vendime apo 92% e tyre janë publikuar në gjuhën shqipe, ndërsa 357 vendime apo 8% prej tyre janë publikuar në gjuhën serbe. Gjuha në të cilën janë publikuar vendimet nga kjo gjykatë është paraqitur në mënyrë grafike në figurën e mëposhtme.



Grafika 5. Gjuha në të cilën janë publikuar vendimet nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Kërkesat e përcaktuara në Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve nuk janë zbatuar në mënyrë të kënaqshme nga kjo gjykatë. Nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, vetëm në 2,790 prej tyre (66%) është respektuar ky vendim, ndërsa në 1,435 vendime (34%) janë evidentuar lëshime në zbatimin e tij.

Në tabelën e mëposhtme është shprehur në mënyrë grafike zbatimi i Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Supreme.




Grafika 5. Përdorimi i Shabllonit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Ndërkaq Udhëzimi Administrativ për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara është zbatuar në nivel të lartë në të gjitha vendimet e publikuara nga kjo gjykatë. Nga 4,225 aktykime të publikuara për periudhën janar-

dhjetor 2024, të dhënat personale janë fshehur me përpikmëri në 4,074 vendime, ndërsa në 151 vendime janë evidentuar lëshime në këtë aspekt.

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Supreme është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 68 ditë për t'i publikuar vendimet, llogaritur nga dita e shpalljes, duke kaluar ndjeshëm kërkesat ligjore.

Gjyqtarët që kanë publikuar më shumë vendime në Gjykatën Supreme, si dhe numri i vendimeve të publikuara nga ta gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.




Grafika 6. Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, gjyqtarët e Gjykatës Supreme me numrin më të lartë të vendimeve të publikuara gjatë vitit 2024 janë: Sahit Sylejmani (377 vendime), Agron Hoxhaj (287 vendime) dhe Asllan Krasniqi (269 vendime).

4. GJYKATA E APELIT


Gjykata e Apelit gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 ka publikuar gjithsej 8,621 vendime gjyqësore. Në këtë periudhë, Gjykata Apelit ka arritur të zgjidh 20,159 lëndë, rrjedhimisht ka publikuar 43% të lëndëve të zgjidhura.

Me këtë rezultat, Gjykata e Apelit renditet si gjykata e pestë për nga transparenca në publikimin e vendimeve nga të gjitha gjykatat në vend.



Grafika 7. Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjyaktën e Apelit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Në figurën e mëposhtëm është paraqitur niveli i publikimit të vendimeve nga Gjykata e Apelit gjatë periudhës janar – dhjetor 2024. Kjo paraqitje vizuale pasqyron trendin mujor të publikimit dhe kontribuon në vlerësimin e vazhdimësisë dhe përkushtimit të gjykatës ndaj transparencës.




Grafika 8. Niveli i publikimit të vendimeve gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 në Gjykatën e Apelit.

Divizioni i Apelit të Mitrovicës, si pjesë e kësaj gjykate, gjatë vitit 2024 ka publikuar vetëm 1 vendim, ndërsa në vitin 2023 nuk kishte publikuar asnjë vendim.

Sa i përket natyrës së lëndëve, Gjykata e Apelit ka publikuar 6,468 vendime të natyrës civile, 1,491 sosh të natyrës penale dhe 662 të natyrës administrative.


Në tabelën e mëposhtme është përshkruar publikimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit, të ndarë sipas llojit të lëndëve.



Grafika 9. Lloji i vendimeve të publikuara nga Gjykata e Apelit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Gjykata e Apelit gjatë kësaj periudhe ka publikuar 78 vendime në lidhje me veprat penale të korrupsionit, ndërsa 1 vendim të dhunës në familje.


Ndërsa sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar vendimet, Gjykata e Apelit ka publikuar 8,582 apo 99% të vendimeve në gjuhën shqipe, ndërsa 48 aktgjykime në gjuhën serbe apo 0,5%. Gjuha e publikimit të aktgjykimeve në mënyrë grafike është paraqitur në figurën e mëposhtme.



Grafika 10. Gjuha në të cilën janë publikuar vendimet nga Gjykata e Apelit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Zbatimi i Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Vendimeve nga kjo gjykatë është arritur në nivel të kënaqshëm. Në pjesën prej 5,963 vendimesh vendimi është zbatuar në përpikmëri, ndërsa në 2,667 vendime ky vendim nuk është zbatuar në mënyrën e përcaktuar në këtë vendim.

Në figurën në vijim është paraqitur niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikara nga Gjykata e Apelit.




Grafika 11. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e Gjykatës së Apelit.

Sa i përket respektimit të Udhëzimit Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara, Gjykata e Apelit nga 8,621 vendime, 807 prej tyre i ka publikuar pa u'a fshehur të dhënat personale subjekteve që kërkohet me këtë udhëzim. Kjo shifer është rritur dukshëm krahasim me vitin e kaluar ku vetëm 50 vendime ishin publikuar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara.

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës së Apelit është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 54 ditë për t'i publikuar vendimet. Nëse e krahasojmë me vitin 2023, kjo gjykatë këtë vit ka shënuar progres sa i përket publikimit të vendimeve në kohë, duke e ulur mesataren e publikimit të vendimeve.

Ndërkaq gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara nga Gjykata e Apelit gjatë kësaj periudhe, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.



Grafika 12. Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën e Apelit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës së Apelit me më së shumti vendime të publikuara janë: Nora Bllaca Dula (384 vendime të publikuara), Naime Ahmeti (364 vendime të publikuara), si dhe Ardian Ajvazi (358 vendime të publikuara).


6. GJYKATA KOMERCIALE

Gjykata Komerciale së bashku me *Dhomën e Shkallës së Parë dhe Dhomën e Shkallës së Dytë* ka publikuar 6,085 vendime gjyqësore për periudhën janar-dhjetor 2024. Ky numër ishte rritur për 44 %, në krahasim me vitin 2023, kur kjo gjykatë në tërësi i kishte publikuar 4,465 lëndë.

Në raport me lëndët e zgjidhura, që në këtë periudhë ishin 6,421 lëndë nga të dy shkallët e kësaj gjykate, kjo gjykatë ka arritur të publikoj 94% të lëndëve që në këtë vit kishin marrur epilog gjyqësor.


Specifikisht, Dhoma e Shkallës së Parë ka publikuar 4,028 vendime nga gjithsej 4,276 lëndë të zgjidhura (94%), ndërsa Dhoma e Shkallës së Dytë ka publikuar 2,056 vendime nga 2,145 lëndë të zgjidhura (96%).

Me këto shifra të publikimit në raport me lëndët e zgjidhura, kjo gjykatë renditet e para për nga niveli i publikimit gjatë vitit 2024.



Grafika 62. Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Komerciale gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Niveli i publikimit të vendimeve nga *Dhoma e Shkallës së Parë* dhe *Dhoma e Shkallës së Dytë*, për secilin muaj të kësaj periudhe është shfaqur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.




Grafika 64. Niveli i publikimit të vendimeve nga Dhoma e shkallës së parë dhe Dhoma e Shkallës së dytë gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Pra siç shihet në figurën e mësipërme, numrin më të madh të aktgjyimeve, Dhoma e Shkallës së Parë i ka publikuar në muajin mars, përkatësisht 742 aktgjykime, ndërsa Dhoma e Shkallës së Dytë numrin më të madh të aktgjyimeve i ka publikuar në muajin prill, përkatësisht 270 aktgjykime.

Sa i përket llojit të vendimeve të publikuara, Gjykata Komerciale për këtë periudhë ka publikuar 3,727 vendime të natyrës ekonomike, 918 vendime të natyrës administrative, 472 vendime të natyrës fiskale dhe 968 vendime të natyrës përmbarimore.


Lloji i vendimeve të publikuara është paraqitur në mënyrë grafike në figurën e mëposhtme.



Grafika 65. Lloji i vendimeve gjyqësore për periudhën janar-dhjetor 2024.


Nga numri i përgjithshëm i publikimit të vendimeve, Gjykata Komerciale ka publikuar 10 vendime në gjuhën serbe (0,2%), ndërsa 6,075 tjera në gjuhën shqipe (99.8%).

Gjuha e vendimeve të publikuara është paraqitur edhe në grafikën e mëposhtme.



Grafika 66. Gjuha në të cilën janë publikuar vendimet në Gjykatën Komerciale gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.


Sa i përket zbatimit të Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për standardizimin e formës së vendimeve, gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 janë evidentuar 373 vendime gjyqësore që nuk janë në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.



Grafika 67. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Komerciale.

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Komerciale është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 77 ditë për t'i publikuar vendimet, llogaritur nga dita e shpalljes. Pra, kjo gjykatë e ka kaluar ndjeshëm kohën e paraparë me ligj për publikimin e vendimeve gjyqësore.

Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara nga Gjykata Komeriale janë paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafika 68. Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Komeriale gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.


Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Komeriale me më së shumti vendime të publikuara janë: Florent Zeqiri (486 vendime të publikuara), Verona Dibra (470 vendime të publikuara), si dhe Hasan Kryeziu (448 vendime të publikuara).

5. GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Gjykata Themelore e Prishtinës, duke përfshirë 5 degët e saj (Dega në Podujevë, Dega në Graçanicë, Dega në Lipjan, Dega në Glllogoc, Dega në Fushë Kosovë), gjatë kësaj periudhe ka publikuar 5,450 vendime.¹¹ Ky nivel i publikimit është rritur për 45% në krahasim me vitin e kaluar, kur kjo gjykatë kishte publikuar vetëm 3,769 vendime.


Gjykata Themelore e Prishtinës në tërësi gjatë vitit 2024 kishte zgjidhur 35,545 lëndë, dhe rrjedhimisht nga të dhënat e monitorimit rezulton se kjo gjykatë ka publikuar vetëm rreth 15 % të vendimeve nga lëndët që gjatë këtij viti kishin marrur epilog gjyqësor.

Me këtë rezultat, duke marrë për bazë numrin e lëndëve të zgjidhura dhe atyre të publikuara për vitin 2024, Gjykata Themelore e Prishtinës rënditet e parafundit nga të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës.



Grafika 13. Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Në grafikën në vijim janë paraqitur të dhënat mbi numrin e vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë periudhës janar - dhjetor 2024, të ndara në muaj.



Grafika 14. Niveli i publikimit të vendimeve në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.


Të gjitha degët e Gjykatës Themelore të Prishtinës, në total, kanë publikuar 1,881 vendime, që përbëjnë 35% të vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë. Dega e Lipjanit gjatë kësaj periudhe ka publikuar 662 vendime nga 4,968 lëndë të zgjidhura (13%), Dega e Podujevës 479 vendime, nga 6,191 lëndë të zgjidhura

¹¹ Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar një shifër prej 755 vendime të tjera të përsëritura dhe procesverbale, që nuk janë përfshirë në këto shifra.

(8 %), Dega e Glllogovcit 307 vendime nga 3,803 lëndë të zgjidhura (8%), Dega e Graçanicës ka publikuar 59 aktgjykime nga 1,125 lëndë të zgjidhura (5 %), ndërsa Dega e Fushë Kosovës ka publikuar 374 vendime nga 5,177 lëndë të zgjidhura (7%).

Krahasuar me vitin e kaluar, Dega e Graçanicës ka shënuar përmirësim në publikimin e vendimeve, me 40 vendime më shumë të publikuara gjatë vitit 2024. Ndërkohë, Dega e Fushë Kosovës, e cila në vitin 2023 kishte zgjidhur 637 lëndë pa publikuar asnjë vendim, ka shënuar progres të dukshëm në vitin 2024 duke publikuar 374 vendime.


Shifrat e publikimit të vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore në Prishtinë gjatë muajve të vitit 2024 janë paraqitur në mënyrë grafike në figurën në vijim. Kjo paraqitje vizuale ofron një pasqyrë të qartë mbi ritmin dhe trendin e publikimit për secilën degë përgjatë vitit.



Grafika 15. Niveli i publikimit të vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Sa i përket llojit të vendimeve të publikuara, Gjykata Themelore e Prishtinës ka publikuar gjithsej 2,475 vendime civile, 2,288 vendime penale dhe 758 vendime administrative.

Lloji i vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Prishtinës është pasqyruar edhe në grafikën e mëposhtme.



Grafika 16. Ndarja e vendimeve të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 nga Gjykata Themelore e Prishtinës.

Nga vendimet penale, 65 vendime janë për veprat penale të keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar, ndërsa 9 vendime të dhunës në familje.


Gjykata Themelore në Prishtinë ka publikuar 344 vendime në gjuhën serbe (6%), krahasuar me vitin e kaluar kur kjo gjykatë kishte publikuar vetëm 14 vendime në gjuhën serbe. Ndërsa pjesa tjetër e

vendimeve janë publikuar në gjuhën shqipe. Në mënyrë grafike, gjuha e publikimit të aktgjykimeve është paraqitur edhe në tabelën e mëposhtme.



Grafika 17. Gjuha në të cilën janë publikuar vendimet gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 nga Gjykata Themelore e Prishtinës.

Vendimi për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është zbatuar në masë të konsiderueshme nga kjo gjykatë. Nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, ky vendim është zbatuar në 4,780 vendime, ndërsa në 670 vendime të tjera janë vërejtur lëshime në zbatimin e tij.¹² Në tabelën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë grafike zbatimi i këtij akti në vendimet e publikuara të kësaj gjykate.




Grafika 18. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve nga Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Ndërkaq, sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, 943 vendime (ose 17%) janë publikuar pa anonimizimin e të dhënave personale të palëve brenda përmbajtjes së vendimeve.

Sipas të dhënave nga monitorimi, Gjykatës Themelore të Prishtinës i janë dashur mesatarisht 174 ditë për të publikuar vendimet gjyqësore, të llogaritura nga data e shpalljes së tyre. Kjo tejkalon dukshëm afatin e paraparë me Ligjin për Gjykatat, si dhe e kalon mesataren e vetë kësaj gjykate nga viti paraprak, kur publikimi i aktgjykimeve bëhej mesatarisht për 117 ditë.

¹² Lëshime janë vërejtur në disa lëndë administrative të cilat publikuar në formatin Ëord dhe jo PDF, siç kërkohet.

Ndërkaq gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti vendime në Gjykatën Themelore në Prishtinë gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, janë paraqitur në grafikonin në vijim.




Grafika 19. Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Prishtinës me më së shumti vendime të publikuara janë: Përparim Zeka (311 vendime), Avdirrahman Gashi (253 vendime) dhe Rexhep Gashi (193 vendime).

7. GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

Gjykata Themelore e Mitrovicës, duke përfshirë katër degët e saj (*Skenderajin, Vushtrrinë, Leposaviqin dhe Zubin Potokun*) gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 në ueb-faqen zyrtare kanë publikuar gjithsej 8,662 vendime.¹³ Ky nivel i publikimit ka shënuar rritje të theksuar në krahasim me vitin paraprak, kur kjo gjykatë kishte publikuar 2,382 vendime, përkatësisht 24% më shumë.


Rrjedhimisht, në krahasim me numrin e lëndëve të zgjidhura nga *Gjykata Themelore e Mitrovicës* gjatë vitit 2024, numër ky që gjatë kësaj periudhe ishte 17,004 lëndë, rezulton se kjo gjykatë (përfshirë degët e saj) ka publikuar 51% të vendimeve nga lëndët e zgjidhura.



Grafika 20. Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Bazuar në këto të dhëna, *Gjykata Themelore e Mitrovicës* është gjykata e cila renditet e katërta për nga numri i lëndëve të zgjidhura në raport me ato të publikuara.

Publikimi i vendimeve nga Gjykata Themelore e Mitrovicës për secilin muaj, në mënyrë grafike është shfaqur në figurën e mëposhtme.



Grafika 21. Niveli i publikimit të vendimeve nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.


Sipas këtij grafikoni, mund të shihet se Gjykata Themelore e Mitrovicës numrin më të madh të vendimeve e ka publikuar në muajin tetor dhe dhjetor.

¹³ Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar edhe 581 vendime të tjera të përsëritura, që nuk janë përfshirë në këto shifra.

Sa i përket degëve të Gjykatës Themelore në Prishtinë, numrin më të madh të vendimeve të publikuara e ka Dega e Vushtrrisë, me 3,114 vendime nga 6,948 lëndë të zgjidhura, që përbëjnë 45%. Dega e Skenderajt ka publikuar 1,806 vendime nga gjithsej 3,186 lëndë të zgjidhura (57%), ndërsa Dega e Leposaviqit ka një shkallë publikimi prej 67%, me 210 vendime nga 312 lëndë të zgjidhura. Nga ana tjetër, Dega e Zubin Potokut ka publikuar 21 vendime nga 93 lëndë të zgjidhura, përkatësisht 23%.


Dega e Skenderajt është dega e dytë cila ka publikuar më së shumti vendime gjyqësore nga degët e gjykatave themelore pa marrë për bazë raportin ndërmjet lëndëve të zgjidhura nga kjo degë.

Publikimi i vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore në Mitrovicë është shfaqur grafiksht në tabelën e mëposhtme.



Grafika 22. Niveli i publikimit të vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.


Gjykata Themelore në Mitrovicë ka publikuar 7,146 vendime civile dhe 1,516 vendime janë të natyrës penale. Në grafikën në vijim është paraqitur lloji i vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 sipas natyrës së veprës.



Grafika 23. Ndarja e vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 sipas llojit të tyre.

Nga vendimet penale, kjo gjykatë gjatë kësaj periudhë ka publikuar 62 vendime të korrupsionit dhe 2 vendime të dhunës në familje.

Ndryshe nga viti 2023, ku asnjë vendim nuk ishte publikuar në gjuhën serbe, në periudhën janar-dhjetor 2024, janë publikuar 45 vendime në gjuhën serbe.



Grafika 24. Ndarja e vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 sipas llojit të tyre.

Sa i përket respektimit të udhëzimit administrativ për anonimizimin e të dhënave, kjo gjykatë gjatë kësaj periudhe ka publikuar 1,426 vendime pa fshehjen e të dhënave personale.

Sa i përket zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve, nga të gjitha vendimet e publikuara nga kjo gjykatë dhe degët e saj, lëshime janë gjetur në 1,223 vendime. Ndërsa në pjesën tjetër prej 7,438 vendimesh, ky vendim është zbatuar me korrektësi.

Në tabelën e mëposhtme, në mënyrë grafike është shfaqur niveli i zbatimit të këtij vendimi nga Gjykata Themelore e Mitrovicës.





Figura 25. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës.

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Mitrovicës është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 55 ditë për t'i publikuar vendimet. Kjo nënkupton se Gjykata Themelore e Mitrovicës sa i përket kohës së publikimit të vendimeve e respekton kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e tyre.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara gjatë kësaj periudhe në Gjykatën Themelore të Mitrovicës.




Grafika 26. Gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti vendime në Gjykatën Themelore të Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës me më së shumti vendime të publikuara janë: Leutrim Gashi (1,010 vendime), Jeton Zymeri (839 vendime), si dhe Hajrullah Aruqi (627 vendime).

8. GJYKATA THEMELORE E PEJËS

Gjykata Themelore e Pejës, duke përfshirë tri degët e saj (*Deçanin, Istogun dhe Klinën*) gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 ka publikuar 2,315 vendime¹⁴, përkatësisht 18% më shumë vendime se në vitin 2023 (1,969 vendime gjyqësore).


Me këto shifra, kjo gjykatë renditet e fundit sa i përket publikimit të vendime gjatë kësaj periudhe. Ndërkaq, në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura, numër ky që gjatë vitit 2024 ishte 19,972 lëndë, rezulton se janë publikuar vetëm 13 % e vendimeve nga lëndët e zgjidhura.



Grafika 27. Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Pejës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Siç shihet në tabelën e vendosur më sipër, pjesën më të madhe të vendimeve kjo gjykatë i ka publikuar gjatë muajit tetor, përkatësisht 312 vendime. Ndërsa më së paku vendime i ka publikuar në muajin gusht, përkatësisht 94 vendime.

Publikimi i vendimeve nga kjo gjykatë gjatë vitit 2024, të ndara në muaj, është pasqyruar në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.




Grafika 28. Numri i vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Pejës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Dega e Istogut gjatë kësaj periudhe kishte publikuar 426 vendime, nga 2,423 lëndë të zgjidhura (18%), *Dega e Klinës* 246 vendime nga 3,117 lëndë të zgjidhura (8%), ndërsa *Dega e Deqanit* 414 vendime nga


¹⁴ Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar edhe 121 vendime të tjera të përsëritura, që nuk janë përfshirë në këto shifra.

4,024 lëndë të zgjidhura (10%). Niveli i publikimit të degëve të Gjykatës Themelore të Pejës për çdo muaj gjatë kësaj periudhe është paraqitur edhe në tabelën e mëposhtme.



Grafika 29. Niveli i publikimit të vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Pejës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.


Nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, 1,203 vendime janë të natyrës penale, ndërsa 1,329 janë të natyrës civile. Natyra e vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë është përshkruar edhe në grafikën e mëposhtme.



Grafika 30. Lloji i vendimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe nga Gjykata Themelore e Pejës.

Nga të gjitha vendimet e publikuara, ne kemi evidentuar vetëm 8 vendime në lidhje me veprat penale të korrupsionit dhe asnjë vendim të dhunës në familje.


Kjo gjykatë nuk kishte publikuar asnjë aktgjykim në gjuhën serbe, njejtë sikurse në vitin paraprak. Kjo është paraqitur në mënyrë grafike edhe në tabelën e mëposhtme.



Grafika 31. Gjuha në të cilën janë publikuar vendimet gjatë kësaj periudhe nga Gjykata Themelore të Pejës.

Gjatë monitorimit, nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë, janë evidentuar 372 vendime të pa-anonimizuara.


Zbatimi i Vendimit të KGJK-së për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është arritur në shumicën e vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë. Lëshime në zbatimin e këtij vendimi janë gjetur në 163 vendime të publikuara.¹⁵ Në tabelën e mëposhtme është shfaqur niveli i zbatimit të këtij vendimi nga kjo gjykatë gjatë kësaj periudhe.



Grafika 32. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Pejës.

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Pejës është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 90 ditë për t'i publikuar vendimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë e ka tejkaluar afatin e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e vendimeve.

Në tabelën e mëposhtme janë listuar gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 nga Gjykata Themelore e Pejës.



Grafika 33. Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 në Gjykatën Themelore të Pejës.


Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Pejës me më së shumti vendime të publikuara janë: Bajram Cacaj (281 vendime), Petrit Nrecaj (247 vendime), si dhe Sabrije Rraci (158 vendime).

¹⁵ Në këtë gjykatë, ka pasur rast kur është publikuar aktgjykim me track-changes.

9. GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT


Gjykata Themelore e Prizrenit, duke përfshirë Degën e Suharekës dhe atë të Dragashit, gjatë periudhës janar-dhejtor 2024 ka publikuar gjithsej 5,609 vendime¹⁶. Në krahasim me vitin paraprak, kur kjo gjykatë i kishte publikuar 4,618 vendime, ky nivel i publikimit të vendimeve gjyqësore këtë vit kishte shënuar rritje për 21%.

Gjatë vitit 2024 kjo gjykatë kishte zgjidhur gjithsej 14,972 lëndë, dhe rrjedhimisht nga të dhënat e monitorimit rezulton se kjo gjykatë ka publikuar 37% të lëndëve. Me këto shifra, kjo gjykatë renditet në vendin e gjashtë për nga numri i publikimit të vendimeve në raport me lëndët e zgjidhura.



Grafika 34. Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Në tabelën në vijim, në mënyrë grafike është pasqyruar shkalla e publikimit të vendimeve nga kjo gjykatë për cdo muaj të kësaj periudhe.




Grafika 35. Niveli i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Sa i përket degëve të kësaj gjykate, Dega e Suharekës kishte publikuar 568 vendime nga 3,948 lëndë të zgjidhura (14%), ndërsa Dega e Dragashit kishte publikuar gjithsej 263 vendime nga 756 lëndë të zgjidhura (35 %).


Publikimi i vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Prizrenit është shfaqur në mënyrë grafike për secilin muaj në tabelën e mëposhtme.

¹⁶ Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar 409 vendime të përsëritura, që nuk janë përfshirë në këto shifra.



Grafika 36. Niveli i publikimit të vendimeve nga Degët e Gjykatës Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.


Sa i përket natyrës së vendimeve të publikuara, kjo gjykatë ka publikuar 1,398 vendime të natyrës penale, ndërsa 4,209 vendime civile. Klasifikimi i vendimeve sipas llojit të tyre është përshkruar edhe në tabelën e mëposhtme.



Grafika 37. Ndarja e vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 sipas llojit të lëndës.

Nga aktgjykimet penale të publikuara, vetëm 7 prej tyre kanë të bëjnë me veprat penale të korrupsionit, ndërsa janë publikuar 2 vendime të dhunës në familje.


Sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar vendimet, duhet të theksohet se gjatë kësaj periudhe nga 5,602 vendime të publikuara vetëm 7 vendime janë publikuar në gjuhën serbe (0.17%). Pra, të gjitha vendimet tjera të Gjykatës Themelore të Prizrenit kanë qenë vetëm në gjuhën shqipe.



Grafika 38. Gjuha në të cilën janë publikuar vendimet nga Gjykata Themelore e Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 sipas llojit të lëndës.

Sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale nga numri i përgjithshëm i vendimve kjo gjykatë ka publikuar 1,426 vendime pa fshehjen e të dhënave personale.¹⁷


Nga të gjitha vendimet e publikuara nga kjo gjykatë, lëshime në zbatimin e Vendimit të Këshillit Gjyqësor për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve janë vërejtur në 212 vendime. Ndërkaq në pjesën tjetër prej 5,397 vendimesh, shablloni është zbatuar në përpikmëri. Në grafikonin e mëposhtëm është përshkruar niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e Gjykatës Themelore të Prizrenit, për çdo muaj.



Grafika 39. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Prizrenit.

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Prizrenit është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 55 ditë për t'i publikuar vendimet llogaritur nga dita e shpalljes, pra kjo gjykatë e ka respektuar afatin e paraparë me Ligjin për Gjykatat.

Gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti vendime në Gjykatën Themelore të Prizrenit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.



Grafika 40. Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Prizrenit me më së shumti vendime të publikuara janë: Baki Shigjeqi me 406 vendime të publikuara, Diona Bajrami me 369 vendime të publikuara, si dhe Shaban Shala me 313 vendime të publikuara.


¹⁷ Ndikim të madh ka pasur fakti që udhëzimi administrativ nuk ishte në përputhje me dispozitat e reja të Kodit të Procedurës Penale.

10. GJYKATA THEMELORE E FERIZAJT

Gjykata Themelore e Ferizajt, duke përfshirë Degën e Kaçanikut dhe atë të Shtërpcës, gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 ka publikuar 3,063 vendime.¹⁸ Krahasuar me vitin 2023, kjo gjykatë nuk ka shënuar ndonjë rritje të theksuar në publikimin e aktgjykimeve, dallimi është vetëm 58 lëndë rritje për këtë vit.


Rrjedhimisht, prej 10,005 lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2024 nga kjo gjykatë, rezulton se gjatë këtij viti janë publikuar 31 % e vendimeve nga lëndët që këtë vit kishin marrur epilog gjyqësor.

Me këto shifra, kjo gjykatë renditet e shtata nga rradhët e gjykatave të shkallës së parë sa i përket publikimit të aktgjykimeve në raport me lëndët e zgjidhura.



Grafika 41. Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën e Ferizajt gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Figura në vijim paraqet në mënyrë grafike publikimin mujor të vendimeve nga kjo gjykatë gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.




Grafika 42. Niveli i publikimit të vendimeve për çdo muaj nga Gjykata Themelore e Ferizajt gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Gjykata Themelore në Ferizaj është gjykata e vetme e cila nuk ka publikuar asnjë vendim në muajin qershor të vitit 2024.

¹⁸ Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar edhe 64 vendime të tjera të përsëritura dhe procesverbale, që nuk janë përfshirë në këto shifra.

Ndërsa, degët e kësaj gjykate kanë publikuar gjithsej 795 vendime gjyqësore gjatë kësaj periudhe. Dega e Kaçanikut gjatë kësaj periudhe ka publikuar 711 vendime nga 2,084 lëndë të zgjidhura (34 %), ndërsa Dega e Shtërpçës ka publikuar 84 vendime nga gjithsej 693 lëndë të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (12 %).


Në tabelën e më poshtme në mënyrë grafike është shfaqur publikimi i vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Ferizajt, për çdo muaj.



Grafika 43. Publikimi i vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Ferizajt gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Gjykata Themelore e Ferizajt gjatë periudhës së monitorimit ka publikuar më shumë aktgjykime të natyrës civile, se sa penale. Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve, 2,184 aktgjykime janë të natyrës civile, ndërsa 880 të natyrës penale.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur lloji i vendimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe nga Gjykata Themelore e Ferizajt.



Grafika 44. Lloji i vendimeve të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 nga Gjykata Themelore e Ferizajt sipas llojit të lëndëve.

Nga të gjitha vendimet penale të publikuara nga kjo gjykatë, 11 prej tyre janë për veprat penale të korrupsionit, ndërsa për këtë vit kjo gjykatë ka publikuar 1 vendim të veprës penale dhunë familje.


Sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar këto vendime, gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 kjo gjykatë ka publikuar 3,047 në gjuhën shqipe (99%) ndërsa 16 aktgjykimet tjera në gjuhën serbe (1%).



Grafika 45. Gjuha në të cilën janë publikuar vendimet gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 nga Gjykata Themelore e Ferizajt sipas llojit të lëndëve.

Gjatë kësaj periudhe të monitrit, Vendimi për Standardizmin e Formave të Vendimeve është zbatuar në 2,558 vendime apo 84% nga totali i përgjithshëm, ndërsa në pjesën tjetër prej 505 apo 16% vendimesh, është vërejtur lëshime në zbatimin e tij.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihet zbatimi i Vendimit për Standardizmin e Formave të Vendimeve nga Gjykata Themelore e Ferizajt.




Grafika 46. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve nga Gjykata Themelore e Ferizajt.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, Gjykata Themelore e Ferizajt ka publikuar 398 vendime pa fshehjen e të dhënave personale, numër i cili është rritur në krahasim me vitin e kaluar.

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Ferizajt është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 47 ditë për t'i publikuar vendimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë vendimet i publikon brenda kohës së paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e tyre.

Në tabelën e mëposhtme janë renditur gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 nga Gjykata Themelore e Ferizajt.




Grafika 47. Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara nga Gjykata Themelore të Ferizajt gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Ferizaj me më së shumti vendime të publikuara janë: Faton Ajvazi (607 vendime), Kreshnike Zymberi - Beqiri (297 vendime) si dhe Riza Livoreka (261 vendime).

11. GJYKATA THEMELORE E GJILANIT


Gjykata Themelore e Gjilanit, duke përfshirë tri degët e saj (*Degën e Kamenicës, Vitisë dhe të Novobërdës*) gjatë kësaj periudhe ka publikuar gjithsej 4,726 vendime, përkatësisht 91 vendime më pak se në vitin 2023.

Rrjedhimisht, nga 15,586 lëndë të zgjidhura nga kjo gjykatë gjatë vitit 2024, rezulton se kjo gjykatë ka arritur të publikoj 30 % të vendimeve nga lëndët të cilat gjatë kësaj periudhe kishin marrur epilog gjyqësor. Ky nivel i publikimit të vendimeve në raport me lëndët e zgjidhura gjatë këtij viti, e rendit Gjykatën Themelore të Gjilanit në vendin e tetë për nga niveli i trasnparencës në publikimin e vendimeve nga të gjitha gjykatat në vend.



Grafika 48. Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjilanit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Niveli i publikimit të vendimeve nga kjo gjykatë për secilin muaj, është paraqitur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.




Grafika 49. Niveli i publikimit të vendimeve nga Gjykata Themelore e Gjilanit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Një numër të madh të vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë e kanë shtuar edhe degët e saj, ku të tri degët e gjykatës kanë publikuar 2,150 vendime gjyqësore apo 45% të vendimeve.


Dega e Vitisë gjatë kësaj periudhe ka publikuar 852 vendime nga 4,674 lëndë të zgjidhura (18%), *Dega e Kamenicës* ka publikuar 806 vendime nga 2,759 lëndë të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (29%), ndërsa *Dega e Novobërdës* ka publikuar 492 vendime nga 589 lëndë të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (83 %).

Niveli i publikimit të vendimeve nga degët e kësaj gjykate për çdo muaj është shfaqur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.



Grafika 50. Niveli i publikimit të vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Gjiçanit.


Pjesa më e madhe e vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë, apo 4,137 vendime, janë të natyrës civile. Ndërsa pjesa tjetër prej 544 vendimesh janë të natyrës penale. Lloji i vendimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe nga kjo gjykatë mund të shihet edhe në grafikën e mëposhtme.



Grafika 51. Ndarja e vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Gjiçanit sipas llojit të lëndëve.


Nga të gjitha lëndët e natyrës penale të publikuara në ueb-faqen e KGjK-së, FOL ka evidentuar 10 vendime të korrupsionit dhe 1 vendim të dhunës në familje.

Nga të gjitha vendimet e publikuara gjatë kësaj periudhe, vetëm 48 prej tyre janë të publikuara në gjuhën serbe (1%), ndërsa pjesa tjetër në gjuhën shqipe (99%).



Grafika 52. Gjuha e aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Gjilanit gjatë vitit 2024.


Gjatë monitorimit, janë evidentuar 242 vendime të pa anonimizuara. Ndërkaq sa i përket Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve nga kjo gjykatë, FOL ka evidentuar 230 vendime në të cilat ka pasur lëshime në zbatimin e këtij vendimi. Niveli i zbatimit të këtij vendimi në mënyrë grafike është paraqitur në tabelën e mëposhtme.



Grafika 53. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Gjilanit.

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Gjilanit është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 33 ditë për t'i publikuar vendimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë e ka respektuar me përpikmëri kohën e paraparë me Ligjin për Gjykatat për publikimin e vendimeve.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara nga Gjykata Themelore e Gjilanit, gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.




Grafika 54. Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjilanit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Gjilanit me më së shumti vendime të publikuara janë: Valbonë Dervodeli (489 vendime), Edona Zuzaki (436 vendime), dhe Florije Qerimi (340 vendime).

12. GJYKATA THEMELORE E GJAKOVËS

Gjykata Themelore e Gjakovës, duke përfshirë *Degën e Rahovecit* dhe atë të *Malishevës*, gjatë kësaj periudhe në ueb-faqen zyrtare ka publikuar gjithsej 7,803 vendime¹⁹. Rjedhimisht, nga 11,767 lëndë të zgjidhura nga kjo gjykatë gjatë vitit 2024, rezulton se kjo gjykatë ka arritur të publikoj rreth 66% të vendimeve.


Bazuar në këto të dhëna, Gjykata Themelore e Gjakovës renditet e treta në nivel vendi për nga numri i vendimeve të publikuara dhe e para në mesin e shtatë gjykatave themelore.



Grafika 55. Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjakovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Niveli i publikimit të vendimeve nga Gjykata Themelore e Gjakovës për secilin muaj të kësaj periudhe është shfaqur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.

¹⁹ Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar edhe 336 vendime të tjera të përsëritura, që nuk janë përfshirë në këto shifra.




Grafika 56. Niveli i publikimit të vendimeve për çdo muaj nga Gjykata Themelore e Gjakovës, gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Edhe degët e kësaj gjykate kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e publikimit të vendimeve në kuadër të kësaj gjykate, duke publikuar gjithsej 3,850 vendime, apo 49% të të gjitha vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë.

Gjatë kësaj periudhe, *Dega e Malishevës* ka publikuar 1,736 vendime nga 3,049 lëndë të zgjidhura (57%), ndërsa *Dega e Rahovecit* ka publikuar 2,114 vendime nga 3,901 lëndë të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (54%).


Në tabelën e mëposhtme në mënyrë grafike është pasqyruar publikimi i vendimeve të degëve të Gjykatës Themelore të Gjakovës gjatë kësaj periudhe.



Grafika 57. Niveli i publikimit të vendimeve nga Degët e Gjykatës Themelore të Gjakovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Sa i përket llojit të vendimeve të publikuara, kjo gjykatë ka publikuar 6,871 vendime të natyrës civile, dhe 932 vendime të natyrës penale.


Kjo ndarje e vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Gjakovës është paraqitur edhe në grafikonin e mëposhtëm.



Grafika 58. Ndarja e vendimeve të publikuar nga Gjykata Themelore e Gjakovës gjatë kësaj periudhe sipas llojit të lëndëve.

Nga vendimet penale, gjatë kësaj periudhe kjo gjykatë ka publikuar 15 aktgjykime në lidhje me veprat penale të korrupsionit dhe asnjë aktgjykim në lidhje me veprat penale të dhunës në familje.

Gjykata Themelore e Gjakovës të gjitha vendimet i ka publikuar në gjuhën shqipe. Pra, nuk ka publikuar asnjë aktgjykim në gjuhën serbe.




Grafika 59. Gjuha e vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Gjakovës gjatë kësaj periudhe.

Sa i përket anonimizimit të vendimeve, gjatë kësaj periudhe janë evidentuar gjithsej 1,421 vendime të publikuara nga Gjykata Themelore e Gjakovës që nuk janë anonimizuar në tërësi.²⁰

Gjithashtu, sikurse tek gjykata tjera, zbatimi i vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për standardizimin e formave të vendimeve nuk ka qenë gjithmonë në nivelin e duhur në Gjykatën Themelore të Gjakovës. Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar 814 vendime të publikuara me mospërputhje me kërkesat e këtij vendimi.


²⁰ Lëshime janë evidentuar në mos-fshehjen e emrave të palëve në procedure, adresat, numra personal etj.



Grafika 60. Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Gjakovës.

Nga monitorimi i procesit të publikimit të vendimeve në Gjykatën Themelore të Gjakovës, është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 42 ditë për t'i publikuar vendimet llogaritur nga dita e shpalljes. Kjo tregon se publikimi i aktgjykimeve është bërë brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjakovës janë paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafika 61. Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjakovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Gjakovës me më së shumti vendime të publikuara janë: Berkan Hamza (726 vendime), Durim Balaj (711 vendime) dhe Blerina Kurtaj (680 vendime).

13. REKOMANDIME

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, rekomandohet ndërmarrja e veprimeve të mëposhtme për të adresuar sfidat e identifikuara dhe për të avancuar më tej transparencën dhe llogaridhënien e sistemit gjyqësor.

Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës:

- Të bëjë monitorimin e zbatimit të akteve nënligjore, përfshirë Udhëzimin Administrativ 01/2025 dhe Vendimin për Standardizimin e Formave të Vendimeve.
- Të përmirësojë funksionalitetin teknik të ueb-faqes, me fokus në eliminimin e problemeve me publikimet e dyfishta dhe numërimin automatik të aktgjykimeve.
- Të organizojë trajnime periodike për gjyqtarë dhe staf mbështetës, duke u fokusuar në anonimizim, standardizim dhe përpunim të vendimeve, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare.
- Të forcojë kapacitetet njerëzore dhe teknike në gjykatat themelore dhe degët e tyre, me qëllim përmirësimin e efikasitetit në përpunimin dhe publikimin e vendimeve.

Për gjykatat:

- Të respektojnë afatin ligjor prej 60 ditësh për publikimin e aktgjykimeve nga data e shpalljes, në përputhje me Ligjin për Gjykatat.
- Të rrisin kapacitetet njerëzore dhe teknike në degët e gjykatave për të përmirësuar efikasitetin në përpunimin dhe publikimin e vendimeve.
- Të sigurojnë publikimin në formatin PDF, sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ, për të ruajtur integritetin dhe qartësinë e dokumenteve.
- Të zbatohet në mënyrë konsekuente anonimizimi i të dhënave personale në përputhje me Udhëzimet Administrative dhe Kodin e Procedurës Penale.
- Të shmangët publikimi i vendimeve që përfshijnë çështje të ndjeshme, si dhuna në familje apo çështje të natyrës familjare, siç kërkohet me ligj.

BURIMET

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, prill 2008.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 06/L-054 për Gjykatat, dhjetor 2018.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-032 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Gjykatat.
- Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ nr. 02/2016 për Anonimizimin dhe Publikimin e Vendimeve të Plotëfuqishme, shkurt 2016.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ nr. 04/2019 për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara, dhjetor 2019.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ nr. 01/2025 për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara, mars 2025.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Shabllonet Standarde të Vendimeve - Vëllimi 1, 2018.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti Statistikor i Gjykatave, 2024.

FOL



Rockefeller
Brothers Fund